

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI FILOZOFIK
DEPARTAMENTI I HISTORISË
PRISHTINË

REZYME E DISERTACIONIT TË DOKTORATËS

HUMANIZMI DHE RENESANCA TË SHQIPTARËT GJATË
SHEK. XV – XVII

MENTOR: PROF.DR. MUHAMET MALA

KANDIDATI: FIDAN ZENELI

PRISHTINË, 2022

Teza e disertacionit “*Humanizmi dhe Renesanca te shqiptarët gjatë shek.XV-XVII*” synon të paraqes një përmbledhje të zhvillimit të humanizmit te shqiptarët në këta shekuj. Ky studim për nga rëndësia është një nga periudhat kryesore në historinë e popullit shqiptar në kontekstin e përgjithshëm kulturor në shekujt më kompleks të qytetërimit evropian përgjithësisht.

Në këtë punim do i shtjellojmë këto ngjarje në mënyrë sa më origjinale dhe do i ofrojmë njohuri të reja siç është periudha e Skënderbeut, do i qasemi në një mënyrë tjetër, që në fokus do të këtë më tepër zhvillimin ekonomik dhe atë kulturor. Studimi shkencorë që shqyrtohet në këtë punim doktrate, i titulluar Humanizmi dhe Renesanca të shqiptarët gjatë shek. XV – XVII, paraqet një kontribut modest jo vetëm në kuadër të historiografisë por është edhe një përpjekje serioze për të ndriçuar një periudhë të rëndësishme të historisë kulturore shqiptare mbështetur në burimet dhe literaturën relevante për sa i përket kësaj periudhe. Veprat me të njohura letrare të periudhës se humanizmit i gjejmë të botuara dhe të krijuara jashtë arealit shqiptar.

Për humanistët e shquar shqiptarë, të cilët shkruanin kryesisht në gjuhën latine, tema kryesore e tyre ishte lufta e Skënderbeut. Ndër më të shquarit padyshim ishin Marin Barleti, Marin Beçikemi, Frang Bardhi, Gjon Gazulli, Leonik Tomeu etj. Që të gjithë këta pasi nuk mund ta ushtronin profesionin e tyre në vendlindje kishin emigruar kryesisht në Itali. Por këtu vlen të theksohet libri i parë i shkruar në gjuhën shqipe, i njohur deri më tani “Meshari” i Gjon Buzukut.

Kultura shqiptare gjatë shekujve XV - XVII është trajtuar deri në një masë nga historiografia shqiptare dhe ajo e huaj. Autorë shqiptarë, që kanë botuar monografi, punime, kumtesa e trajtesa për shqiptarët në shekujt XV - XVII, që në mënyrë direkte, apo indirekte, prekin disa segmente nga kjo çështje. Mirëpo, duhet të theksohet fakti se ka pasur historianë dhe studiues shqiptar si: Injac Zamputi, Eqrem Çabej, Aleks Buda, Kristo Frashëri, Skënder Anamali, Kasem Biçoku, Skënder Rizaj, Mahmud Hysa, Muhamet Ternava, Ferit Duka, Pëllumb Xhufi, Koço Bozhori, Fadil Bytyçi, Selim Daci, Shaban Demiraj, Jahja Drançolli, Muhamet Mala, Dritan Egro, Nuri Bexheti, Muhamet Qerimi, Bardhyl Demiraj, Lulëzim Lajçi, Gjon Berisha, Teuta Shala – Peli, Ardian Muhaj etj. Ndërsa nga studiues të huaj veçojmë Hahn. J. G, Milan Shuflaj, Konstantin Jeriçek Noel Malcom, Oliver Jens Schmitt, Peter Bartl, Edwin Jacques, Jacques Bourcart, Nuray Bozborra, Le Jacques Goff, Zhan Klod Faverial, Evlija Çelebi etj., të cilet kanë trajtuar tema të

ndryshme për shqiptarët në kohën e humanizmit, ndërsa të veprat e tyre i kemi shfrytëzuar nga publikimet që janë botuar në gjuhën e tyre, ose nëpërmjet studiuesve shqiptarë, që kanë shqyrtuar veprat e tyre. Për të finalizuar këtë punim të doktoratës, janë shfrytëzuar burimet primare dhe ato sekondare, që kemi vjelë në institucione të ndryshme kërkimore-shkencore (arkiva e biblioteka), kombëtare e ndërkombëtare, në Kosovë, Shqipëri, Mal të Zi, Kroaci etj. Hulumtimet kryesore i kemi zhvilluar në arkivat dhe në bibliotekat në Shqipëri, në radhë të parë në Arkivin Qendror Shtetëror të Republikës së Shqipërisë (AQSH), Arkivin e Institutit të Historisë në Tiranë të cilat nuk janë të specifikuar me fonde përkatëse por të shpërndara me Signatura të cilat përmbajnë dokumente të përkthyer nga Arkivi i Dubrovnikut.

Në Bibliotekën Kombëtare në Tiranë kemi vjelur burime të botuara si: *Acta et diplomata res Albaniae aetatis illustrantia*, college Thollozy-Jirecek, Sufflay, vol.I-II, Vindobonae, 1913-1918, *Dokumente të shek.XVI-XVIII për historinë e Shqipërisë, vëll.I-II (1507-1592)*, përgatitur nga Injac Zamputi, Tiranë, 1989, *Defterin e regjistrimit të Sanxhakut të Shkodrës së vitit 1485*, redaktuar nga Selami Pulaha dhe botuar në Tiranë më 1989 etj. Nga Arkivi i Dubrovnikut kemi vjelur dokumente arkivore të pabotuara në fondet: *Acta Concili Minoris, Reformationes, Lettere e Commissioni di Levante, Acta Concili Rogatorum*. Në Arkivin e Kotorrit kemi vjelur fondet : *Sudsko notarski spisi (Acta notarialia) (1332-1795)*; *Kancelarija rektora i providura mletačke republike (atti dell'ufficio della cancelleria commune) – kotor (1420-1797); 1652-1804*.

Në bazë të materialit të elaboruar lidhur me humanizmin dhe renesancën te shqiptarët gjatë shek. XIV-XV kemi arritur në disa përfundime interesante që shprehin këto marrëdhënie në tërë kompleksitetin e vet. Diaspora e rëndësishme arbëreshe, e shpërngulur në Itali si pasojë e pushtimit Osman në gjysmën e dytë të shekullit XV, nga radhët e së cilës dolën artistë si Andrea Alexi e shkencëtarë si Leonik Tomeu, të dy me prejardhje nga Durrësi, zejtarët e tregtarët e asaj të famshmes <*Scuola degli albanesi*> në Venedik, kondotierë si K. Arianiti, etj. Kultura mesjetare shqiptare arriti një kulm të saj me kontributin që dha në lëvizjen e madhe evropiane të Rilindjes së diturive dhe arteve. Edhe pse në mërgim, humanistët e mëdhenj shqiptarë si M. Biçikemi e M. Barleti, të dy me prejardhje nga Shkodra, mbetën të lidhur me atdheun e tyre me lidhjet e interesit shkencor, po aq sa me ndjenjat e tyre patriotike. Më qëllim që studimi në fjalë të formësohet sa më mirë, dhe për të ardhmen të jetë një udhërrëfyes për çështje dominikane, shoh të nevojshme, që t'i përmendi edhe disa burra të shquar të urdhrit dominikan me origjinë arbërore si: frater *Gjon Durrsaku*, profesor i filozofisë në Universitetin e Padovës gjatë viteve 1392 – 1397; frater *Alex*

Durrsaku, lektor në Universitetin e Bolonjës dhe në Universitetin e Pragës (1393); frater *Gjon Mazreku i Durrësit*, prior provincial i Provincës së Dalmacisë (1393); frater *Shtjefën Zaharia*, konventual i Kuvendit të Ulqinit (1393); frater *Gjergj Durrsaku*, student i filozofisë në Universitetin Ferrara (1399); frater *Mikel Durrsaku*, student i teologjisë në Kuvendin Papal të Lombardisë (1396 – 1397); frater *Ndre Durrsaku*, konventual i Kuvendit e Ankonës të Provincës së Lombardisë së Poshtme (1396); frater *Aleks Durrsaku*, profesor në Perugja (1477); frater *Gjon Ndre Suma i Shkodrës*, gjithashtu profesor në Perugja (1477); frater *Pjetër Radoni*, rregulltar në trevat arbërore të Venedikut (1486); frater *Jan Nika*, pleban i Novobërdës (1488); frater *Vlash Shkodrani*, vikar i Kuvendit të Arbanonit (1497); motra *Domenika nga Tivari* (1492 – 1493); frater *Nikollë Durrësaku*, magjistër general dhe prior i Durrësit (1492); frater *Alberti i Novobërdës*, konventual i Kuvendit të Raguzës (1499 – 1529); frater *Lukë Mazi* i Trepçës, i shquar për kujdesin ndaj të krishterëve arbër në Kosovë gjatë viteve 1534 – 1536, etj. Plejadën e humanistëve shqiptarë të shekujve XV, XVI e hap Gjon Gazulli. Personaliteti i tij na shfaqet në shumë drejtime: njeri politik, drejtues shkollash humaniste, astronom dhe matematikan i dëgjuar, pedagog dhe shef katedre universitare, mbi të gjitha atdhetar i flaktë. Të ngritur në dije dhe me kulturë të gjerë për kohën, rektorë shkollash humanist qenë edhe dy vëllezërit e tij Pali dhe Andrea, që të dy të ngarkuar nga Skënderbeu me detyrën e ambasadorit në Raguzë. Vëllezërit Gazulli qenë bashkëkohës, bashkatdhetarë dhe bashkëpunëtorë të afërt të heroit tonë kombëtar.

Në historinë e kulturës shqiptare veprimtaria e tyre e shumanshme në dobi të Atdheut dhe në zhvillimin e kulturës humaniste të Rilindjes ka një vend të merituar. Mikel Maruli, që nga shekulli XVI emri i tij hyri në tekste e studime për letërsinë e Rilindjes Evropiane dhe të humanizmit, në enciklopedi speciale e universale. Ai zuri vend me rëndësi për idetë e guximshme materialiste mbi botën e shoqërinë, i ndikuar nga veprat e autorëve materialistë të antikitetit; u çmua dhe u nderua për ndikimin që ushtroi me veprat e tij. Ka qenë edhe poet me aftësi dhe ide përparimtare për kohën në të cilën jetoi e punoi.

Marin Barleti është figura kryesore e mendimtarëve tanë të shquar e përparimtarë të shekujve XV, XVI për rëndësinë e madhe kombëtare të dy veprave të tij, *“Rrethimi i Shkodrës”*. Dhe *“Historia e Skënderbeut”*, për idetë e tij patriotike dhe humaniste të shprehura qartë në shkrimet e tij, për jehonën që patën në botë këto dy botime kushtuar heroit tonë kombëtar, luftës së popullit tonë dhe mbrojtësve heroikë të Shkodrës. Në epokën e Rilindjes Evropiane asnjë nuk i

këndoi si ai me aq pasion e frymëzim patriotik epopesë sonë të lavdishme nën udhëheqjen e Gjergj Kastriotit – Skënderbeut. Emri i tij është kështu i lidhur me atë të Heroit dhe me epokën zulmëmadhe të shekullit XV. Nikollë Tomeu, i njohur në qarqet humaniste të Rilindjes Evropiane dhe në botimet shkencore të mëvonshme me emrin latin Nicolas – Leonic Thomeus (Leonik është anagrama jo e plotë e emrit Nicolo – Nikollë), ka qenë një ndër filozofët më të shquar të shekullit XVI, me dije të shumanshme dhe personalitet i nderuar. Marin Beçikemi është një ndër humanistët shqiptarë më të njohur brenda dhe jashtë atdheut, për dashurinë që ushqe për Shqipërinë, për idetë e tij përparimtare që shfaqte ai. Si shkrimtar, si pedagog, si diplomat, si historian dhe sidomos si orator i shkëlqyer, ai e bëri të njohur edhe emrin e Shqipërisë dhe të përfaqësuesve të saj në zë. U shqua për një jetë kulturore të pasur dhe veprimtari politike të gjallë. Shkroi një sërë veprash të një rëndësie të veçantë kombëtare e shoqërore. Për kulturën e tij të gjerë humaniste, për krijimtarinë e tij të pasur e të shumanshme, për karakterin përparimtar të veprës së tij Mihal Artioti zë një vend të rëndësishëm në humanizmin e shekujve XV, XVI.

Të efektshme ishin edhe përpjekjet për të ruajtur e zhvilluar kulturën shqiptare në kushtet e sundimit osman. Në këtë periudhë dolën edhe shkrimet e para në gjuhën shqipe përmes përkthimeve të shkrimeve fetare nga Gj. Buzuku, P. Budi etj., apo të krijimeve letrare shqiptare me modele orientale. Që në shekujt e hershëm vendi ynë që djepi i mjeshtërive të ndërtimit të banesave, të urave, të kështjellave, të faltoreve me një teknikë të lartë ndërtimi dhe me një arkitekturë të përsosur, Shqipëria që vendi i mjeshtërive e artistëve zejtarë që punonin arin, argjendin, koralin, fildishin, sedefin, që punonin e gdhendnin gurin, mermerin, drurin etj. Me këto objekte të bukura e të qëndrueshme zejtarët, ndërtuesit dhe artistët shqiptarë zbukurorin qytetet si dhe banesat e mjediset kudo që ata jetonin.

Këta mjeshtër shqiptarë, duke qenë punëtorë të aftë, me talent e fantazi krijuese, me iniciativë, kërkoheshin shumë edhe në viset e tjera të Ballkanit dhe në Apellgun e Mesdheut. Vetëm nga Shqipëria e Veriut në shekullin XIV kemi të shpërngulur me punë në Dalmaci 40 arkitektë skulptorë e piktorë shqiptarë, që lanë emër me veprat e tyre të krijuara me shije e qëndresë. Që këtej në këtë periudhë na paraqitën emrat zë mëdhenj të artistëve arbëror si Viktor Karpaj, Andrea Aleks, Mark Bazaiti, pastaj edhe muzikantët arbëror që vepruan në Raguzë e Itali. Mund të themi se Humanizmi dhe Renesanca gjatë shek. XV-XVII luajti një rol të pamohueshëm nga arbërorët. Këta emra që vepruan dhe jetuan jashtë atdheut të tyre arbëror pas

pushtimit osman, i dhanë një dimension të ri jetës kulturore, arsimore dhe shkencore për kohën e tyre. Me kontributin e tyre vetanak këto koka që në fushat e sipër përmendura i dhanë një pasqyrë të re, kombit shqiptar duke e renditur atë ndër kombet më të emancipuar të Evropës së shek. XV-XVII, dhe në këtë kontekst populli shqiptar nuk mbeti anash nga popujt tjerë evropian, emancipimit të përgjithshëm evropian, duke i kontribuar atij reciprokisht me frymën e kohës, në kulturë dhe shkencë.